

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.8, datë 14.2.2008

**LIDHUR ME PROCEDURAT E RIMBURSIMIT TË AKCIZËS SË LËNDËVE DJEGËSE
TË PËRDORURA NGA SUBJEKTET PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, pikës 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.839, datë 5.12.2007 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së paguar dhe përjashtimin nga taksa doganore për makineritë dhe pajisjet, përdorur nga burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW”, Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës,

UDHËZOJMË:

1. Në subjektet që kanë ndërtuar burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, dega e tatimeve e rrethit përkatës, ku është regjistruar subjekti, në bashkëpunim me strukturat shpërndarëse të energjisë elektrike, kryejnë procedurat e mëposhtme:

a) Inspektorët e organit tatimor dhe inspektorët e strukturave shpërndarëse të energjisë elektrike, bëjnë plumbosjen e matësve të energjisë elektrike, duke vendosur në procesverbalin e mbajtur: orën, ditën e leximit të kontaktorit, si dhe kodin e plumbosjes (secila palë të ketë kodin e plumbosjes së vet).

b) Inspektorët e organit tatimor do të kontrollojnë çdo muaj sasinë e energjisë elektrike të prodhuar për shitje, për nevojat e veta dhe të prodhuar gjithsej (vlerësuar si diferencë e leximeve të matësit në fillim dhe në fund të muajit) si dhe bëjnë verifikimin e plumbosjes, së bashku me inspektorët e strukturave shpërndarëse të energjisë elektrike. Për këtë, nga ana e inspektorëve të tatimeve do të përpilohet procesverbali përkatës me të dhënat e mësipërme, i cili do të firmoset nga të dyja palët. Procesverbali do të mbahet në tre kopje. Një kopje i lihet subjektit, një i jepet inspektorit të strukturave shpërndarëse të energjisë elektrike dhe kopja tjetër mbahet nga inspektori i organit tatimor.

c) Mbas paraqitjes së të dhënave të kërkuara në shkronjën “a” dhe “b”, më sipër, dega e tatimeve të rrethit ku është regjistruar subjekti që ka ndërtuar burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, për nevojat e veta apo për shitje, plotëson tabelën 1 dhe tabelën 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, të cilat duhet të dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me shkresë, brenda datës 5 të muajit pasardhës të mbylljes së tremujorit (bashkëlidhur tabelave domosdoshmërisht edhe procesverbalet e mbajtura).

2. Personi juridik, vendas ose i huaj, i cili ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burime të tjera të rinovueshme të prodhimit, duhet të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të dhënat e kërkuara sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.839, datë 5.12.2007, brenda datës 5 të muajit pasardhës të mbylljes së tremujorit.

3. Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga llogaria e veçantë buxhetore, e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim, dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e kërkesës së subjektit për rimbursim të akcizës, duke e llogaritur vlerën e akcizës, që do të rimburohet, sipas formulës së paraqitur në shtojcën 1, që i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.839, datë 5.12.2007, dhe duke u bazuar në dokumentacionin e përshkruar në pikën “1 gërma c” dhe pikën “2” të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.839, datë 5.12.2007 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së paguar dhe përjashtimin nga taksa doganore për makineritë dhe pajisjet, përdorur nga burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të

instaluar jo më pak se 5 MW”.

